

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Arsimit dhe Sportit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	<p>Programi Qeverisës 2021-2025</p> <p>Vendim nr. 88, datë 22.2.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”</p> <p>Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” (SKA 2021-2026)</p> <p>Vendim nr. 210, datë 6.4.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030”</p>
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	04/07/2023
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 04/07/2023
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2023 – MAS – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	<p>Mirela Bimo Mirela.bimo@arsimi.gov.al</p> <p>Nadire Pilavi Nadire.Pilavi@arsimi.gov.al</p> <p>Voltisa Koçi Voltisa.Koçi@arsimi.gov.al</p>

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Sektori i shëndetësisë u vendos në një sprovë të madhe për të përballuar situatën e paprecedentë gjatë kohës së pandemisë COVID-19, e cila pati impakt serioz në nivel global në jetën e individëve duke sjellë nevojën e përballjes me sfida të reja. Në kontekstin aktual është me rëndësi të madhe përgatitja e profesionistëve që i shërbejnë sistemit shëndetësor shqiptar për të menaxhuar pasojat e Covid-19, në mënyrë sa më efikase që të jetë e mundur dhe për të zhvilluar këtë sektor shëndetësor edhe në të ardhmen.

Sigurimi i burimeve njerëzore të duhura për shëndetin është një përparësi, për pasojë duhet të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave të burimeve njerëzore për shëndetin, si dhe të tregohet një kujdes i veçantë për të vlerësuar planifikimin dhe prodhimin aktual të fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësor, në raport me nevojat e tregut aktual të punës në shëndetësi duke identifikuar nevojat dhe opsionet kryesore për një strategji burimesh njerëzore në këtë sektor.

Ministria e Arsimit dhe Sportit i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor, si dhe punësimit të studentëve të mjekësisë pas përfundimit të studimeve, duke i dhënë përparësi punësimit të tyre në sektorin e mjekësisë në vend, si dhe krijuar efekte afatgjata në përmirësimin e cilësisë së shërbimit shëndetësor në vend.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Nxitja e kandidatëve/studentëve të mjekësisë që të kontribuojnë në sistemin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë.
- Sigurimi i burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.
- Zhvillimi i vazhdueshëm i karrierës së studentëve të fushës së mjekësisë, duke e bërë sektorin e shëndetësisë sa më atraktiv dhe të konkurueshëm me vendet e rajonit.
- Punësimi prioritar i studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, në institucionet shëndetësore, nga momenti i lindjes të së drejtës për punësim.
- Dhënia përparësi në përfshirjen në programet sociale të strehimit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 0 (status quo): Mosndërhyrja e qeverisë nëpërmjet një mekanizmi rregullator apo jo rregullator, për të ndryshuar/modifikuar qasjen e ndjekur deri më tani, shoqërohet me avantazhet dhe disavantazhet e saj. Mosmarrja e masave duke vijuar me situatën ekzistuese nuk zgjidh problematikat e lartpërmendura dhe në mungesë të ndërhyrjes gjendja do të mbetet e parregulluar dhe problematikat e evidentuara do të mbeten të patrajuara. Ky opsion nënkupton mosndërmarrjen e një nisme në fushën e sektorit shëndetësor.

Opsioni 1 Hartimi i projektligjit: “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë””. Ky projektligj, duke ofruar trajtim të veçantë për kandidatët/studentët që regjistrohen për herë të parë apo ndjekin programin e integruar të studimit “Mjekësi e Përgjithshme” dhe që pranojnë të punojnë në vend pas diplomimit të tyre, do të nxisë të gjithë studentët që të kontribuojnë në sistemin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë, si dhe u jep atyre një shtysë për ecurinë e tyre dhe përfshirjen në tregun e punës pas diplomimit.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është opsioni më i mirë për të trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, kur plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj, si dhe sigurimi i burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Opsioni 2 jorregullator: Për të realizuar objektivat e synuara është marrë në konsideratë edhe opsioni jorregullator...

Problemi ka karakter legjislativ dhe çdo opsion me karakter jorregullator nuk i shërben qëllimit dhe arritjes së objektivave, pasi nëpërmjet përcaktimeve të projektligjit synohen të bëhen përcaktime që në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, duhet të bëhen vetëm me ligj.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Ndikimet ekonomike

Miratimi i këtij projektligji mund të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit/Universitetin e Mjekësisë Tiranë, vetëm në rast se të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen për mbajtjen e diplomës për një periudhë 2 (dy)-vjeçare deri 5 (pesë)-vjeçare pas përfundimit të studimeve.

Sipas një skenari optimist, nëse të gjithë studentët pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe të punojnë në Republikën e Shqipërisë, efekti financiar shtesë, që duhet të përballohet nga buxheti i shtetit apo universiteti, përlllogaritet rreth 38 835 000 lekë të ardhura të munguara për shkak të përjashtimit të të gjithë studentëve nga tarifatat e shkollimit dhe do të nevojiten fonde shtesë për të përballuar këtë efekt financiar nga buxheti i shtetit.

Aktualisht, janë 863 studentë, të cilët përfitojnë përjashtimin nga tarifa e studimit, me efekt financiar 38 835 000 lekë.

Sipas një skenari më realist, supozohet se 50% e studentëve do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe në këtë skenar, efekti financiar përlllogaritet sa më poshtë:

- Efekti financiar për studentët që do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen (përveç atyre që tashmë e përfitojnë përjashtimin) për shkak se do të nënshkruajnë marrëveshjen për qëndrim 2-5 vjeçar në Shqipëri përlllogaritet: $325 \text{ studentë} \times 45.000/2 \text{ lekë} = 7.312.500 \text{ lekë}$ fonde të nevojshme nga buxheti i shtetit për përballimin e përjashtimit nga tarifa. Kjo kategori studentësh supozohet se do të paguajë 50% të tarifës (45.000/2 lekë).

- Fondet nga arkëtimi i tarifave të studimit për pjesën e studentëve që nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje, do të vlerësohen pas përcaktimit të metodologjisë përkatëse, e cila do të realizohet sipas përcaktimeve të nenit 5 të këtij projekt ligji. Në një vlerësim optimal, tarifatat aktuale të studimit në programin e studimit mjekësi e përgjithshme vlerësohen në intervalin 6%-8% të kostos së plotë të studimeve. Pas miratimit të këtij projekt ligji, institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë koston reale të studimit, e cila do të realizohet sipas një metodologjie të përcaktuar. Elementët kyç mbi të cilët do të bazohet metodologjia e përlllogaritjes së kostos, janë shpenzimet e personelit, të cilat në institucionet e arsimit të lartë publike vlerësohen rreth 75% të kostos së studimit, shpenzimet korrente për blerje mallrash dhe shërbimesh të cilat vlerësohen rreth 10% të kostos dhe shpenzimet kapitale të cilat zënë vlerësohen rreth 15% të kostos së studimit.

Sipas një skenari pesimist, në rast se të gjithë studentët nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe do të paguajnë koston e plotë të studimeve, efekti financiar në të ardhura (bazuar në koston e përafërt të studimit) përlllogaritet rreth 1,6 miliardë lekë shtesë, por sipas këtij skenari, asnjë student nuk do të pranojë të nënshkruajë marrëveshje për qëndrim 2-5-vjeçar në Shqipëri, që në vlerësimin tonë është një skenar jorealistic. *Ndikimet sociale*

Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.

Arsimi i lartë synon që t'u sigurojë të diplomuarve aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave që i përgjigjen kontekstit të ekonomive të sotme të globalizuara, të drejtuara nga inovacioni dhe të bazuara në aftësi. Sistemet e arsimit të lartë përpiqen të prodhojnë të diplomuar me njohuri dhe aftësi të theksuara teknike, profesionale dhe të disiplinës specifike, veçanërisht në fushën e mjekësisë, e cila përbën fushën më të rëndësishme të jetës dhe shëndetit të qytetarit.

Me qëllim ruajtjen e burimeve njerëzore, profesionistëve shëndetësorë në vend, por dhe rritjen e interesit të tyre për të punuar në sektorin shëndetësor publik, si pjesë e rritjes së investimeve në shëndetësi, propozohet kjo nismë e cili synon mbështetjen financiare të kandidatëve/studentëve që regjistrohen apo ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e Përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë, me qëllim krijimin, ruajtjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e shëndetësisë për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Ndikimet mjedisore

Kjo nismë vlerësohet se nuk përmban impakte mjedisore.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Në krahasim me opsionet e tjera opsioni 1 është vlerësuar si opsioni i preferuar dhe me efektiv, pasi vetëm ky opsion do të sjellë përmbushjen e qëllimit kryesor për të cilin po draftohet ky projektligj. Në krahasim me dy opsionet e tjera, ky opsion arrin të përmbushë misionin si dhe të ketë efekte pozitive në buxhetin e IAL-se, duke siguruar të ardhura shtesë në buxhet me rreth 588 milion lekë.

Nëpërmjet këtij opsioni realizohet zgjidhja në mënyrë thelbësore dhe përmbajtësore e problematikave të evidentuara në fushën e mjekësisë se përgjithshme gjatë zbatimit të ligjit aktual në fuqi.

Ky opsion do të mundësojë arritjen e objektivave ligjore që lidhen me arsimin e larte si dhe do të kontribuojë në sigurimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor për periudhat në vijim.

Kostoja e përlloritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-veçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

(Në milion lekë)

Viti 1 - 2023	Viti 2 - 2024	Viti 3 - 2025
588	500	400

Sqarojmë se kostot financiare që shoqërojnë ndryshimet e parashikuara në projektligj, do të konsiderohen gjatë procesit të përgatitjes së PBA 2024-2026 (faza e dytë) dhe në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2024-2026. Këto efekte do të përlllogariten dhe dërgohen në MFE, për të konsideruar impaktin shtesë në buxhet.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Nisma propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Projektligji, i cili do të shqyrtohet në Kuvend, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, propozojmë të shqyrtohet dhe miratohet me procedurë të përshpejtuar, për shkak të nevojës emergjente që paraqitet për miratimin dhe hyrjen në fuqi të tij, para fillimit të procedurave për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve për studentë në fushën e mjekësisë për vitin e ri akademik 2023-2024. Në këtë aspekt theksojmë se duke qenë se viti i ri akademik fillon më datë 02.10.2023 dhe aplikimet për të përzgjedhur programet e studimit fillon gjatë muajit korrik, vlerësojmë se është shumë e domosdoshme që ligji të ketë hyrë në fuqi para zhvillimit të procedurave për regjistrim nga studentët me qëllim që ata të njihen me përmbajtje e ti dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatim.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar, janë :

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Institucionet publike të arsimit të lartë;
- Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Si çdo krizë, edhe pandemia botërore e COVID-19, i solli botës një tragjedi të re, por në të njëjtën kohë edhe një mundësi për të parë të ardhmen në një dritë tjetër. Shumë studime të publikuara sot mbi shkaqet, pasojat dhe efektivitetin e politikave të ndjekura nga vende të ndryshme në përgjigje të pandemisë, sugjerojnë së pari nevojën për një koordinim më të mirë të politikave sektoriale nacionale, me një qasje të orientuar nga shëndeti dhe, së dyti, një koordinim më të mirë për një përgjigje të unifikuar globale ndaj sfidave që dalin përtej kufijve nacionalë.

Pandemia gjeneroi efekte negative sa në aspektin shëndetësor, aq edhe në atë ekonomik dhe financiar, në edukim, transport, turizëm, mjedis, kohezionin social etj. Ndaj, politikat për rimëkëmbjen pas pandemisë do të duhen rimodeluar për të adresuar në të njëjtën kohë efektet dhe për të prodhuar impakt në shumë sektorë.

Spektori i shëndetësisë u vendos në një sprovë të madhe për të përballuar situatën e paprecedentë gjatë kohës së pandemisë COVID-19, e cila pati impakt serioz në nivel global në jetën e individëve duke sjellë nevojën e përballjes me sfida të reja. Efektet e pandemisë kanë lënë gjurmë në jetën e përditshme të miliarda njerëzve në mbarë botën, kanë sfiduar sistemet kombëtare shëndetësore, shkencën dhe teknologjinë, si dhe kanë ridimensionuar shërbimet dhe punësimet në këtë sektor.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Në kontekstin aktual është me rëndësi të madhe përgatitja e profesionistëve që i shërbejnë sistemit shëndetësor shqiptar për të menaxhuar pasojat e Covid-19, në mënyrë sa më efektive që të jetë e mundur dhe për të zhvilluar këtë sektor shëndetësor edhe në të ardhmen.

Sipas të dhënave të OECD, deri në 2017 rreth 770 mjekë shqiptarë punonin në vende të tjera brenda OECD. Kjo është shifra e dytë më e ulët në rajon pas Malit të Zi (46 mjekë). Shifrat më të larta i arrin Serbia me 2,486 mjekë, pasuar nga Maqedonia e Veriut me 1,726 dhe Bosnia dhe Herzegovina me 1,129 mjekë.

Ndërkaq, vlerësohet se deri në 2022 totali i mjekëve të trajnuar në Shqipëri, por që punojnë në vendet e OECD është mbi 1,200 mjekë, me mbizotërim largimin drejt Gjermanisë, SHBA, Britanisë së Madhe, Kanadasë dhe Italisë. Shkalla e emigrimit vlerësohet të jetë rreth 19.8%, ose ndryshe e thënë, për çdo 10 mjekë që trajnohen në Shqipëri, afërsisht 2 largohen jashtë vendit.

Sipas bazës së të dhënave të OECD-së, totali i mjekëve që punojnë në vendet e OECD-s por janë trajnuar në vendet e Ballkanit Perëndimor vlerësohet afër 7,000 në vitin 2021, shifër e cila do të thotë 13% e mjekëve të disponueshëm në rajonin e Ballkanit.

Sigurimi i burimeve njerëzore të duhura për shëndetin është një përparësi, për pasojë duhet të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave të burimeve njerëzore për shëndetin, si dhe të tregohet një kujdes i veçantë për të vlerësuar planifikimin dhe prodhimin aktual të fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësor, në raport me nevojat e tregut aktual të punës në shëndetësi duke identifikuar nevojat dhe opsionet kryesore për një strategji burimesh njerëzore në këtë sektor.

Për t'iu përgjigjur mungesave të burimeve njerëzore dhe sfidave për t'i mbajtur burimet ekzistuese në qendrat shëndetësore, duhet të eksplorojnë opsionet për ngritjen e kapaciteteve, dhënien e stimujve të ndryshëm për studentët që ndjekin studimet në fushën e mjekësisë së përgjithshme, mekanizmat për të motivuar profesionistët e shëndetit për të vazhduar punën në Shqipëri dhe sipas nevojave edhe në zona rajonale dhe të largëta, me qëllim për të siguruar një shpërndarje më të mirë të burimeve njerëzore në fushën e shëndetësisë.

Përmirësimi i kushteve të punës, zgjerimi i fushës së praktikës së profesionistëve, si dhe investimi në një numër të mjaftueshëm punonjësish të kualifikuar shëndetësorë mund të kontribuojë në reduktimin e mungesave të fuqisë punëtore dhe problemeve që lidhen me mbajtjen e tyre në vendin e punës.

Grupet e prekura nga ky problem janë qeveria, qytetarët, biznesi, shoqëria civile, si dhe veçanërisht kandidatët/studentët e mjekësisë.

Kryerja e një transformimi të suksesshëm të kujdesit shëndetësor dhe krijimi i politikave të reja në këtë fushë do të kërkonte kapacitete të rëndësishme analitike dhe planifikimi në mënyrë që të llogariten të gjitha nevojat e mundshme të burimeve njerëzore për të ardhmen, kjo gjithashtu do të ndihmonte për të siguruar që sistemi i transformuar i kujdesit shëndetësor të kishte fuqinë punëtore deri në detyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor të përqendruar tek individit.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ministria e Arsimit dhe Sportit i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor, si dhe punësimit të studentëve të mjekësisë pas përfundimit të studimeve, duke i dhënë përparësi punësimit të tyre në sektorin e mjekësisë në vend, si dhe krijuar efekte afatgjata në përmirësimin e cilësisë së shërbimit shëndetësor në vend.

Kjo ndërhyrje është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 68/2021 “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, i cili synon ndër të tjera përmirësimin e shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe një strategji të re për shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kjo politikë është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, e miratuar me vendimin nr. 88, datë 22.2.2023 të Këshillit të Ministrave, konkretisht me qëllimet e politikës në fushën e arsimit, në fushën e shëndetësisë dhe në atë të punësimit, përkatësisht si më poshtë:

“3. Arsimi i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetin akademik dhe transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit;

“2. Progresi drejt mbulimit universal shëndetësor nëpërmjet sigurimit të përgjigjes së sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të popullatës”;

“2. Mundësimi i punësimit të denjë nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në tregun e punës”.

Kjo nismë është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave. Vizioni i MAS-it për sektorin e arsimit synon ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë, studentëve etj. duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre.

Përmes ndërhyrjes synohet përmbushja e objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, si më poshtë:

Objektivi specifik C.3 : Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës;

Objektivi specifik C.5: Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.

Arsimi i lartë synon që t’u sigurojë të diplomuarve aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave që i përgjigjen kontekstit të ekonomive të sotme të globalizuara, të drejtuara nga inovacioni dhe të bazuara në aftësi. Sistemet e arsimit të lartë

përpiqen të prodhojnë të diplomuar me njohuri dhe aftësi të theksuara teknike, profesionale dhe të disiplinës specifike, veçanërisht në fushën e mjekësisë, e cila përbën fushën më të rëndësishme të jetës dhe shëndetit të qytetarit.

Kjo politikë përmbush edhe synimet dhe objektivat e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, të miratuar me vendimin nr. 210, datë 6.4.2022 të Këshillit të Ministrave.

Propozimi nuk është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për t'u miratuar në vitin 2023, si dhe nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (aquis communautaire).

Me qëllim ruajtjen e burimeve njerëzore, profesionistëve shëndetësorë në vend, por dhe rritjen e interesit të tyre për të punuar në sektorin shëndetësor publik, si pjesë e rritjes së investimeve në shëndetësi, propozohet kjo nismë e cila synon mbështetjen financiare të kandidatëve/studentëve që regjistrohen apo ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, me qëllim krijimin, ruajtjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e shëndetësisë për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Ndërhyrja ka ardhur edhe si nevojë e përmirësimit në mënyrë të vazhdueshme të arritjeve akademike të studentëve, përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë, si dhe një mbështetje për të rritur dhe përmirësuar statusin ekonomik të studentëve.

Gjithashtu, edhe si një mbështetje në veprimtarinë akademike të institucioneve të arsimit të lartë.

Në kuadrin e nevojave për shkak të pandemisë COVID-19, u vunë në dispozicion 25 milionë euro për të forcuar sistemin shëndetësor, i cili mundësoi garantimin e mbrojtjes së stafit mjekësor me pajisje mbrojtëse personale kudo në sistemin publik, por edhe për zhvillimin e gjithanshëm të këtij sektori, për të tërhequr sa më shumë personel mjekësor në dhënien e kontributit për përballimin e situatës.

Punësime shtesë janë bërë edhe në shërbimet epidemiologjike të strukturave shëndetësore, në të gjithë vendin me qëllim forcimin e kapaciteteve të hetimit epidemiologjik dhe gjurmimit të rasteve gjatë pandemisë.

Gjithashtu, është punësuar personel shtesë shëndetësor, për të siguruar rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore në spitalet Covid-19.

Në këtë drejtim, për të plotësuar nevojat e popullatës për kujdesin e duhur mjekësor, strukturat shëndetësore punuan për të siguruar:

- Vazhdimësinë e kujdesit për të ofruar shërbime për popullatën;
- Ngritjen e kapaciteteve në spitalet rajonale për diagnostikimin dhe trajtimin e diagnozave të ndryshme;
- Sigurimin e kujdesit të koordinuar shëndetësor dhe mbështetjes sociale nga një ekip profesionistësh të kujdesit mjekësor dhe social.

Përtej kësaj, fushat kryesore shqetësuese të identifikuara si ndikuese në arritjen e synimeve për shëndetin dhe të lidhura me shëndetin përfshijnë:

- o financimin e sektorit shëndetësor;
- o organizimin e fragmentuar të kujdesit shëndetësor me përgjegjësi dhe autonomi të kufizuar;
- o kapacitetet e ulëta dhe mbajtjen e profesionistëve të kujdesit shëndetësor;
- o shpërndarjen e pabarabartë të burimeve njerëzore të sektorit shëndetësor në të gjithë vendin;
- o cilësinë e ulët, integrimin dhe përdorimin e të dhënave për shëndetin dhe të lidhura me shëndetin, si dhe mungesën e sistemit të vetëm të informacionit shëndetësor;
- o mungesën e referencës sistematike për standardet e kujdesit dhe shërbimeve që mbështeten në evidenca.

Implementimi i disa programeve, masave dhe politikave kanë dhënë rezultatet e para, duke rritur ndjeshëm densitetin e mjekëve. Aktualisht rreth 5 400 mjekë ofrojnë shërbim në sistemin shëndetësor, përkthyer në 1.93 mjekë për çdo 1 000 banorë. Si rezultat i politikave të ndjekura, vërehet një rritje e densitetit të mjekëve krahasuar me 2013 (ku regjistroheshin rreth 1.2 mjekë/1 000 banorë). Gjithsesi, mbetet ende punë për të rritur më tej dendësinë e mjekëve në vend, dhe për ta çuar në nivelin e vendeve të rajonit (2.6 mjekë/ 1 000 banorë), e më tej edhe në nivelin e vendeve të OECD (3.6 mjekë/ 1 000 banorë). Në përpjekje për të arritur këtë, janë ndërmarrë e vijojnë të implementohen në vazhdimësi një sërë masash, ku ndër më të rëndësishmet mund të përmendim:

- ✓ Rritja historike e pagave të mjekëve;
- ✓ Akordimi i bonusit për mjekët që punojnë në spitale larg vendbanimit;
- ✓ Bonusi për mjekët e sistemit parësor që punojnë në qendra shëndetësore në zona të izoluara;
- ✓ Implementimi i portaleve mjekë dhe infermierë për Shqipërinë, të cilët kanë rritur transparencën dhe besueshmërinë tek procesi i punësimit në bazë të meritokracisë;
- ✓ Investimi në përmirësimin e kushteve të punës dhe modernizimin e pajisjeve dhe infrastrukturës spitalore për t'i mundësuar mjekëve eksperiencën profesionale të denja dhe të plota;
- ✓ Implementimi i ligjit të ri për autonominë spitalore krijon hapësira për stimulimin e karrierës profesionale të mjekëve duke lejuar praktikën e dyfishtë mjekësore, etj.

Gjithashtu, për t'iu përgjigjur nevojave të sistemit dhe për të kundërshtuar efektin e largimit të mjekëve jashtë vendit, ka nisur rritja graduale e kuotave të çelura çdo vit për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” në Universitetin e Mjekësisë së Tiranës, duke arritur në 500 brenda 2024.

Pavarësisht të gjitha arritjeve falë implementimit të politikave të mësipërme, ka një nevojë imediate për të adresuar në mënyrë më shteruese dhe më konkrete fenomenin e largimit të mjekëve nga sistemi dhe nga vendi dhe boshllëqet e krijuara për pasojë.

Projeksionet dhe vlerësimet e situatës për të ardhmen janë bërë duke marrë parasysh një sërë faktorësh, si përqindjen e mjekëve të cilët dalin në pension çdo vit, peshën që zënë mjekët e moshës 55-65 vjeç, si dhe prurjet e reja që do të ketë sistemi prej licencimeve në sistemin publik dhe jopublik.

Sa më sipër nevojiten politika dhe programe afatmesme që të sigurojnë disponibilitetin e profesionistëve të shëndetësisë për të garantuar që fuqia e punës në shëndetësi t’i përgjigjet mbi të gjitha sigurisë së shëndetit të popullatës, bazuar në zhvillimet demografike dhe në përgjigje të fenomeneve si ai i mobilitetit të mjekëve në vende të tjera.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Nxitja e kandidatëve/studentëve të mjekësisë që të kontribuojnë në sistemin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë.
- Sigurimi i burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.
- Zhvillimi i vazhdueshëm i karrierës së studentëve të fushës së mjekësisë, duke e bërë sektorin e shëndetësisë sa më atraktiv dhe të konkurueshëm me vendet e rajonit.
- Punësimi prioritar i studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, në institucionet shëndetësore, nga momenti i lindjes të së drejtës për punësim.
- Dhënia përparësi në përfshirjen në programet sociale të strehimit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo): Mosndërhyrja e qeverisë nëpërmjet një mekanizmi rregullator apo jo rregullator, për të ndryshuar/modifikuar qasjen e ndjekur deri më tani, shoqërohet me avantazhet dhe disavantazhet e saj. Mosmarrja e masave duke vijuar me situatën ekzistuese nuk zgjidh problematikat e lartpërmendura dhe në mungesë të ndërhyrjes gjendja do të mbetet e parregulluar dhe problematikat e evidentuara do të mbeten të patrajtuara. Ky opsion nënkupton mosndërmarrjen e një nisme në fushën e sektorit shëndetësor.

Opsioni 1 Hartimi i projektligjit: “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë””.

Zbatimi i parashikimeve të këtij projektligji do të synojë zhvillimin e vazhdueshëm të karrierës së studentëve të fushës së mjekësisë, duke e bërë sektorin e shëndetësisë sa më atraktiv dhe të konkurrenshëm me vendet e rajonit.

Ky projektligj, duke ofruar trajtim të veçantë për kandidatët/studentët që regjistrohen për herë të parë apo ndjekin programin e integruar të studimit “Mjekësi e Përgjithshme” dhe që pranojnë të punojnë në vend pas diplomimit të tyre, do të nxisë të gjithë studentët që të kontribuojnë në sistemin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë, si dhe u jep atyre një shtysë për ecurinë e tyre dhe përfshirjen në tregun e punës pas diplomimit.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është opsioni më i mirë për të trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, kur plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj, si dhe sigurimi i burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Opsioni 2 jorregullator: Për të realizuar objektivat e synuara është marrë në konsideratë edhe opsioni jorregullator.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
- *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuar.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuar krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura nga kjo ndërhyrje janë kandidatët/studentët e mjekësisë, qeveria, qytetarët, biznesi dhe shoqëria civile.

Ndikimet ekonomike

Miratimi i këtij projektligji mund të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit/Universitetin e Mjekësisë Tiranë, vetëm në rast se të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen për mbajtjen e diplomës për një periudhë 2 (dy)-vjeçare deri 5 (pesë)-vjeçare pas përfundimit të studimeve.

Sipas një skenari optimist, nëse të gjithë studentët pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe të punojnë në Republikën e Shqipërisë, efekti financiar shtesë, që duhet të përballohet nga buxheti i shtetit apo universiteti, përlogaritjet rreth 38 835 000 lekë të ardhura të munguara për shkak të përjashtimit të të gjithë studentëve nga tarifatat e shkollimit dhe do të nevojiten fonde shtesë për të përballuar këtë efekt financiar nga buxheti i shtetit.

Aktualisht, janë 863 studentë, të cilët përfitojnë përjashtimin nga tarifa e studimit, me efekt

financiar 38 835 000 lekë.

Sipas një skenari më realist, supozohet se 50% e studentëve do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe në këtë skenar, efekti financiar përlllogaritet sa më poshtë:

- Efekti financiar për studentët që do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen (përveç atyre që tashmë e përfitojnë përjashtimin) për shkak se do të nënshkruajnë marrëveshjen për qëndrim 2-5 vjeçar në Shqipëri përlllogaritet: $325 \text{ studentë shtesë} * 45.000/2 \text{ lekë} = 7.312.500 \text{ lekë fonde}$ të nevojshme nga buxheti i shtetit për përballimin e përjashtimit nga tarifa. Kjo kategori studentësh supozohet se do të paguajë 50% të tarifës (45.000/2 lekë).

- Fondet nga arkëtimi i tarifave të studimit për pjesën e studentëve që nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje, do të vlerësohen pas përcaktimit të metodologjisë përkatëse, e cila do të realizohet sipas përcaktimeve të nenit 5 të këtij projekt ligji. Në një vlerësim optimal, tarifat aktuale të studimit në programin e studimit mjekësi e përgjithshme vlerësohen në intervalin 6%-8% të koston së plotë të studimeve. Pas miratimit të këtij projekt ligji, institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë koston reale të studimit, e cila do të realizohet sipas një metodologjie të përcaktuar. Elementët kyç mbi të cilët do të bazohet metodologjia e përlllogaritjes së koston, janë shpenzimet e personelit, të cilat në institucionet e arsimit të lartë publike vlerësohen rreth 75% të koston së studimit, shpenzimet korrente për blerje mallrash dhe shërbimesh të cilat vlerësohen rreth 10% të koston dhe shpenzimet kapitale të cilat zënë vlerësohen rreth 15% të koston së studimit.

Sipas një skenari pesimist, në rast se të gjithë studentët nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe do të paguajnë koston e plotë të studimeve, efekti financiar në të ardhura (bazuar në koston e përafërt të studimit) përlllogaritet rreth 1,6 miliardë lekë shtesë, por sipas këtij skenari, asnjë student nuk do të pranojë të nënshkruajë marrëveshje për qëndrim 2-5-vjeçar në Shqipëri, që në vlerësimin tonë është një skenar jorealit.

Ndikimet sociale

Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.

Arsimi i lartë synon që t'u sigurojë të diplomuarve aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave që i përgjigjen kontekstit të ekonomive të sotme të globalizuara, të drejtuara nga inovacioni dhe të bazuara në aftësi. Sistemet e arsimit të lartë përpiqen të prodhojnë të diplomuar me njohuri dhe aftësi të theksuara teknike, profesionale dhe të disiplinës specifike, veçanërisht në fushën e mjekësisë, e cila përbën fushën më të rëndësishme të jetës dhe shëndetit të qytetarit.

Ndikime të tjera janë ruajtja dhe rritja e numrit të profesionistëve shëndetësorë në vend, si pjesë e zhvillimit të burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë; rritja e interesit të tyre për të punuar në sektorin shëndetësor publik, si pjesë e rritjes së investimeve në shëndetësi; mbështetja financiare e kandidatëve/studentëve që regjistrohen apo ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë.

Ndikimet mjedisore

Ky projektligj vlerësohet se nuk përmban impakte mjedisore.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i zgjedhur si i preferuar është opsioni nr. 2 që parashikon hartimin e një projektligji pasi kjo situatë nuk ka një parashikim ligjor sipas atij që propozohet nëpërmjet ndërhyrjet legislative. Në kushtet kur interesi publik për të garantuar plotësimin e nevojave për burime njerëzore në kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë është mjaft i lartë dhe nevojat e diktuar në vend për përmbushjen e këtij interesi të lartë publik janë parësore hartimi I një projektligji të ri mbetet opsioni i preferuar. Duke qenë se ndërhyrja lidhet me krijimin e një marrëdhënie të re juridike dhe me rregullimin e një marrëdhënieje për të cilën nuk ka tashmë një kuadër rregullator, ky opsion vlerësohet si opsioni i preferuar.

Ruajtja e status quo-s ose ndërhyrja jorregullatore, sjell si pasojë mungesën e plotësimin me staf mjekësor të institucioneve që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor, duke ndikuar edhe në interesin publik. Interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë, mbizotëron ndaj pritshmërisë së subjekteve në fjalë (studentëve që janë në ndjekje e sipër të programit të studimit në mjekësi) për të vijuar edhe kohën e mbetur të studimit me të njëjtin trajtim dhe kushte që kanë patur deri më tani. Kjo pritshmëri nuk mund të ketë prioritet ndaj interesit të përgjithshëm për sigurimin e shërbimit shëndetësor në tërësi.

Në krahasim me opsionet e tjera është vlerësuar si opsioni i preferuar dhe me efektiv, pasi vetëm ky opsion do të sjellë përmbushjen e qëllimit kryesor për të cilin po draftohet ky projektligj. Në krahasim me dy opsionet e tjera, ky opsion arrin të përmbushë misionin si dhe të ketë efekte pozitive në buxhetin e IAL-së, duke siguruar personel shëndetësor si dhe duke sjellë te ardhura shtese në buxhet me rreth 588 milion lekë.

Nëpërmjet këtij opsioni realizohet zgjidhja në mënyrë thelbësore dhe përmbajtësore e problematikave të evidentuara në fushën e mjekësisë së përgjithshme gjatë zbatimit të ligjit aktual në fuqi.

Ky opsion do të mundësojë arritjen e objektivave ligjore që lidhen me arsimin e lartë si dhe do të kontribuojë në sigurimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor për periudhat në vijim.

(Në milion lekë)

Financimi	Viti 1_ 2023	Viti 2_ 2024	Viti 3_2025
Total			
Buxheti i shtetit	588	500	400
Të pambuluara			

Sqarojmë se kostot financiare që shoqërojnë ndryshimet e parashikuara në projektligj, do të konsiderohen gjatë procesit të përgatitjes së PBA 2024-2026 (faza e dytë) dhe në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2024-2026. Këto efekte do të përlllogariten dhe dërgohen në MFE, për të konsideruar impaktin shtesë në buxhet.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Institucionet publike të arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, do të jenë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Institucionet publike të arsimit të lartë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit do të jenë përgjegjës për mbulimin e shpenzimeve për kostot e studimeve të studentëve që pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të marrë masat për punësimin me prioritet të studentëve që nënshkruajnë marrëveshje.

AKFAL

Pengesat për zbatimin e opsionit të preferuar mund të jenë vonesat në miratimin e projektligjit, si dhe mospranimi për të nënshkruar marrëveshja nga studentët.

Masat që do të merren për zbatimin e këtij projektligji do të fillojnë nga viti akademik 2023-2024 deri në vitin akademik 2027-2028, për pasojë efekti i tij do të jetë i përkohshëm, që të investojmë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor kombëtar të fortë, rezistent, për të përmirësuar kapacitetet, duke ruajtur forcën e punës në shëndetësi dhe duke promovuar kujdesin social, njëlloj i rëndësishëm me atë shëndetësor.

Ky propozim i përcjellë përmes këtij projektligji është mbështetës për kandidatët/studentët e mjekësisë, pasi me nënshkrimin e marrëveshjes së sipërcituar, ata mund të përfitojnë nga e drejta

për të mospaguar detyrimet financiare që lidhen me pagimin e tarifës së studimeve për gjatë viteve që do të ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, si dhe nga lehtësi të tjera që jepen përmes këtij projektligji.

Po ashtu, theksojmë se punësim do të konsiderohet edhe periudha e specializimit afatgjatë, pavarësisht llojit të kuotës së fituar, ku një pjesë e studentëve përveç se kryejnë procesin e specializimit në strukturat shëndetësore përkatëse, duke kontribuar si në zhvillimin e tyre profesional, (edhe do të paguhet për rastin e studentëve që u përkasin kuotave të mbuluara në specializimet afatgjata në mjekësi, duke respektuar detyrimet sipas marrëveshjes përkatëse të nënshkruar me Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë), ashtu edhe në përmbushjen e detyrimit si periudhë punësimi në Shqipëri.

Sipas përcaktimeve të këtij projektligji respektohet vullneti i lirë i çdo kandidati apo studenti për të vendosur vet nëse do të përfitojë nga të drejtat e përcaktuara në këtë ligj, me nënshkrimin e marrëveshjes apo në të kundërt të përballojë tarifën e studimeve deri në nivelin e kostos së tyre, sipas metodologjisë së përcaktuar me akt nënligjor.

Tarifat e reja të përcaktuara, në rast të mosnënshkrimit të marrëveshjes i referohen vetëm viteve të ardhshme akademike, pa patur efekte prapavepruese. Kjo kategori studentësh do të përfshihet si pjesë e zbatimit të projektligjit me qëllim plotësimin sa parë të nevojave për mjekë me qëllim mbulimin me shërbim shëndetësor sa më cilësor për qytetarët kudo ato ndodhen.

Kandidatët/studentët, që kanë nënshkruar marrëveshje kanë përparësi në përfshirjen në programet sociale të strehimit. Masa e subvencionimit të interesave të kredisë për strehim, llogaritet si diferencë midis interesit të dakordësuar me institucionet financiare dhe interesit që paguan studentit.

Efektet e tij i përkasin së ardhmes, ku theksojmë se kjo vlen edhe për studentët e ndërmjetëm, që aktualisht ndjekin këtë program studimi në institucionin e arsimit të lartë publik, për të cilët efektet e zbatimit të këtij projektligji vlejnë vetëm për vitet e mbetura për të kryer nga ana e tyre.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Për vitin e ardhshëm akademik do të jetë aplikimi për herë të parë i këtij projektligji ku do të vlerësohen kërkesat e studentëve të institucioneve publike të arsimit të lartë, për të nënshkruar marrëveshje dhe për të përfituar sipas këtij ligji dhe numri i këtyre studentëve që do të punësohen pas këtij viti duke qenë se përfshihen edhe studentët e ndërmjetëm. Në vijimësi do të vlerësohen numri i studentëve që do të përfitojnë çdo vit dhe mbulimi i nevojave për staf shëndetësor.

Monitorimi i kësaj politike do të organizohet nga institucionet publike të arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë dhe Ministria përgjegjëse për shëndetësinë e cila është përgjegjëse për punësimin e personelit shëndetësor.

Treguesit që do të përdoren për vlerësimin e arritjes së objektivave janë:

- Numri i studentëve përfitues;

- Buxheti i alokuar për IAL-të publike në fushën e shëndetësisë dhe ndikimi i tij në buxhetin e shtetit;
- Mbajtja e një raporti vjetor për studentëve përfitues që janë punësuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor;
- Plotësimi i nevojave të institucioneve shëndetësore sipas planeve të tyre për burime njerëzore të fushës së shëndetësisë.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Miratimi i këtij projektligji mund të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit/Universitetin e Mjekësisë Tiranë, vetëm në rast se të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen për mbajtjen e diplomës për një periudhë 2 (dy)-vjeçare deri 5 (pesë)-vjeçare pas përfundimit të studimeve.

Sipas një skenari optimist, nëse të gjithë studentët pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe të punojnë në Republikën e Shqipërisë, efekti financiar shtesë, që duhet të përballohet nga buxheti i shtetit apo universiteti, përlllogaritet rreth 38 835 000 lekë të ardhura të munguara për shkak të përjashtimit të të gjithë studentëve nga tarifat e shkollimit dhe do të nevojiten fonde shtesë për të përballuar këtë efekt financiar nga buxheti i shtetit.

Aktualisht, janë 863 studentë, të cilët përfitojnë përjashtimin nga tarifa e studimit, me efekt financiar 38 835 000 lekë.

Sipas një skenari më realist, supozohet se 50% e studentëve do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe në këtë skenar, efekti financiar përlllogaritet sa më poshtë:

- Efekti financiar për studentët që do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen (përveç atyre që tashmë e përfitojnë përjashtimin) për shkak se do të nënshkruajnë marrëveshjen për qëndrim 2-5 vjeçar në Shqipëri përlllogaritet: $325 \text{ studentë shtesë} * 45.000/2 \text{ lekë} = 7.312.500 \text{ lekë fonde të nevojshme nga buxheti i shtetit për përballimin e përjashtimit nga tarifa. Kjo kategori studentësh supozohet se do të paguajë 50% të tarifës (45.000/2 lekë).$

- Fondet nga arkëtimi i tarifave të studimit për pjesën e studentëve që nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje, do të vlerësohen pas përcaktimit të metodologjisë përkatëse, e cila do të realizohet sipas përcaktimeve të nenit 5 të këtij projekt ligji. Në një vlerësim optimal, tarifat aktuale të studimit në programin e studimit mjekësi e përgjithshme vlerësohen në intervalin 6%-8% të kostos së plotë të studimeve. Pas miratimit të këtij projekt ligji, institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë koston reale të studimit, e cila do të realizohet sipas një metodologjie të përcaktuar. Elementët kyç mbi të cilët do të bazohet metodologjia e përlllogaritjes së kostos, janë shpenzimet e personelit, të cilat në institucionet e arsimit të lartë publike vlerësohen rreth 75% të kostos së studimit, shpenzimet korrente për blerje mallrash dhe shërbimesh të cilat vlerësohen rreth 10% të kostos dhe shpenzimet kapitale të cilat zënë vlerësohen rreth 15% të kostos së studimit.

Sipas një skenari pesimist, në rast se të gjithë studentët nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe do të paguajnë koston e plotë të studimeve, efekti financiar në të ardhura (bazuar në koston e përafërt të studimit) përlllogaritet rreth 1,6 miliardë lekë shtesë, por sipas këtij skenari, asnjë student nuk do të pranojë të nënshkruajë marrëveshje për qëndrim 2-5-vjeçar në Shqipëri, që në vlerësimin tonë është një skenar jorealit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR

[Emri Mbiemri]